



Revista

E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

Nr. 71 • Viti XXI i botimit • 2017 • www.kksh.org.al

8 MAJ

NJË DATË DY VEPRIMTARI

DITA BOTËRORE E KRYQIT TË KUQ DHE E GJYSMËHËNËS SË KUQE

**Konkursi XXI Kombëtar
"Kryqi i Kuq dhe Fëmijët"**



FUSHATË PËR PROMOVIMIN E VLERAVE HUMANITARE

**Konkursi XIX Kombëtar i
Ndhmës së Parë**



MËSONI SI TË JEPET NDIHMA E PARË



ORGAN I KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR,
SHPËRNDARHET FALAS.

KRYQI I KUQ SHQIPTAR

Është shoqata më e vjetër humanitare në Shqipëri. Ai është themeluar në vitin 1921 dhe është njohur zyrtarisht nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq më 1923. Që nga ai vit është anëtar i Federatës (në atë kohë Ligës) së Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, duke qenë kështu shoqata e 38-të e themeluar deri atëherë. Në këtë mënyrë Kryqi i Kuq Shqiptar është pjesë e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Sipas nenit 1 të Ligjit Nr.7864 për Kryqin e Kuq Shqiptar, të miratuar nga Parlamenti Shqiptar më datë 29.9.1994, Kryqi i Kuq Shqiptar është një shoqatë humanitare vullnetare që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur në bazë të parimeve themelore të Lëvizjes ndërkombëtare humanitare të Kryqit të Kuq e Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 maj 1957 - dhe Protokolleve shtesë të 10 qershorit 1977 - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 16 qershor 1993. Ai është ndihmës i organeve të pushtetit për çështjet humanitare në mbarë vendin.



Së bashku për humanizmin



VIZIONI

Kryqi i Kuq Shqiptar synon të jetë një shoqatë humanitare e zhvilluar, që punon për përmirësimin e jetës dhe dinjitetit të njerëzve në nevojë, në përputhje me parimet themelore të Lëvizjes.

MISIONI

Kryqi i Kuq Shqiptar ndihmon, nëpërmjet veprimtarisë së vet humanitare, njerëzit më në nevojë duke mobilizuar forcën e humanizmit të shoqërisë shqiptare.

Këshilli Botues

Redaktori përgjegjës:

Zamir Muça

PËRMBAJTJA

8 Maj - Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe e Gjysmëhënës së Kuqe	4
Shërbimi i Trajnimit për Ndihmën e Parë	6
Integrimi i gruas në tregun e punës – një projekt me vlerë i Kryqit të Kuq	8
14 Qershori, Dita Botërore e Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut - Kryqi i Kuq Amerikan në Shqipëri në vitin 1919	10
Intervista jonë – Me ambasadorin e dëshirës së mirë të Kryqit të Kuq Danez Thorbjorn Pedersen	12
Kriza e emigrimit në Europë dhe Kryqi i Kuq	14
Nga veprimtaritë e Kryqit të Kuq Shqiptar dhe të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe	16
	18

Lutemi që të dërgoni artikujt apo materialet tuaja apo kërkesë për informacion, apo korrespondencën tuaj në adresën:

Kryqi i Kuq Shqiptar, rr. "Muhamet Gjollësha", Kutia Postare 1511, Tiranë

Repsioni: + 355 4 2 257 532 **Tel/Fax:** + 355 4 2 225 855 + 355 4 2 222 037 **Email:** kksh@kksh.org.al **Faqja në internet:** <http://www.kksh.org.al>

Redaksia falënderon të gjithë anëtarët, vullnetarët, të punësuarit në KKSH dhe bashkëpunëtorët jashtë tije, për ndihmën e dhënë në nxjerrjen e këtij numri të revistës. Revista e Kryqit të Kuq Shqiptar del tri herë në vit në një tirazh prej 1500 kopje. • Revista shpërndahet falas. • Opinione të shprehura janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin e Kryqit të Kuq Shqiptar. Çdo artikull i dërguar, por jo i kërkuar është i mirëpritur por nuk do të kthehet. • Redaksia rezervon të drejtën që të redaktojë artikujt. Artikujt dhe fotografitë që nuk i nënshtrohen të drejtës së autorit mund të rishkruhen pa një autorizim paraprak, lutemi citoni Kryqi i Kuq Shqiptar. • Shkrimet e publikuar në këtë revistë kanë një vlerë tërësisht informative dhe janë të zhveshura nga çdo lloj nënkuptimi politik.

Një rrugëtim i suksesshëm i shoqatës

KRYQI KUQ SHQIPTAR NDËR 50 SHOQATAT MË TË VLËRËSUARA NË BOTË



Ndërsa njihen arsyet që çuan qeverinë shqiptare t'ia kalonte veprimtaritë e Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSH) Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 1969, nuk janë të qarta ato që shpunë qeverinë të lejonte riorganizimin e tij në vitin 1989. Sidoqoftë, kjo, veç nevojës që mund të ndjejë dikush për të kënaqur kuriozitetin e tij, nuk ka ndonjë rëndësi tjetër. E rëndësishme për qytetarët që ndërmorën nismën për riorganizimin e KKSH ishte fillimi nga puna dhe, siç do fillim, edhe ky kishte vështirësitë e tij.

Sidoqoftë, kur ekziston një dëshirë, gjendet gjithmonë rruga për jetësimin e saj. Hapat e para kishin të bënin me përcaktimin e rregullave që do të mundësonin legjitimitetin e strukturave të shoqatës. Në vend ekzistonte një vakuum ligjor që të mundësonte një gjë të tillë. Nga ana tjetër, në ato vite, nuk njiheshin mjaft koncepte të punës dhe organizimit të jetës së brendshme të shoqatës kombëtare. Si në çdo ambient të jetës sociale të asaj kohe, mentaliteti i njerëzve ishte ai i formatuar në sistemin monist dhe shkëputja prej tij kërkonte kohën e vet. Mjafton të përmendim një realitet të asaj periudhe. Në një kohë kur shoqata kishte përqafuar Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, ndërmjet të cilave “Pavarësia” është një prej tyre, në zyrën ku ishin vendosur dhe punonin drejtuesit e saj, vazhdonte të qëndronte i varur në mur portreti i udhëheqësit të kohës së monizmit, edhe pse në vend ishin mbajtur zgjedhjet e para pluraliste, ato të

marsit 1991. Askujt, kjo gjë nuk ia vriste syrin, pasi ai realitet merrej si i mirëqënë apo, si diçka, që ndryshe nuk mund të konceptohej.

Paradoksalisht, gjendja e rëndë ekonomike në të cilën ndodhej vendi asokohe, shërbeu si një premisë pozitive për rritjen e zhvillimin e KKSH.

Shoqata, me synimin për të kontribuar sado pak në lehtësimin e kësaj gjendje ekonomike, iu drejtua me një herë Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, me kërkesën për të ndihmuar shtresat në nevojë të popullit shqiptar. Ndihma e kërkuar mbërriti në pak kohë dhe, menjëhere me të, mbërriti edhe një delegacion i Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (Federata), i cili u vendos pranë KKSH. Delegacioni i Federatës qëndroi vite të tëra në Shqipëri dhe ndihmoi shoqatën jo vetëm në aspektin e kontributit material për më nevojtarët por, edhe për të riorganizuar dhe ndihmuar në zhvillimin e shoqatës kombëtare mbi bazën e Parimeve Themelore të Kryqit të Kuq e të Gjysmëhënës së Kuqe. Kështu, gjatë kësaj kohe, shoqata organizoi fushatën për anëtarësime, krijoi strukturat e saj në nivel lokal dhe qendror si dhe hartoi dhe miratoi Statutin e saj, duke u mbështetur në *statutin-tip* të Federatës, i cili rekomandohet për shoqatat kombëtare. Në këtë mënyrë, KKSH kishte një statut që, nga pikpamja formale dhe e përmbajtjes së tij, ishte nga më të mirët në nivel ndërkombëtar. Duket pak i çuditshëm ky pohim, por realisht është i vërtetë. Është i njohur fakti se shoqatat kombëtare të vendeve të zhvilluara, duke qenë se janë të vjetra, jetojnë në një farë simbioze interesante ndërmjet përvojës e kapaciteteve të mëdha nga njera anë dhe, atavizmat e një realiti të ndryshëm nga ai i sotëm përse i përket aspektit legjislativ, nga ana tjetër. Kjo gjë bën që, për arsye kryesisht burokratike por dhe jo vetëm, të pranojnë të bashkëjetojnë si të munden me realitetin aktual, me kushtin që të mos i kthehen cënimit të traditës.

Thënë këtë, kemi pranuar se në aspektin legal, KKSH kishte hedhur një hap të rëndësishëm në Asamblenë e tij të parë, në nëntor 1992, kur aprovoi statutin e

tij dhe përfundoi riorganizimin e shoqatës. Pra, shoqata kombëtare rilindi si një fëmijë i shëndoshë, duke bartur të gjitha premiset që edhe rritja e zhvillimi i saj të ishin të shëndetëshme. Dhe nuk kishte si ndodhte ndryshe pasi gjatë kësaj kohe, delegacioni i Federatës i qëndroi pranë, duke e ndihmuar atë të rritej e zhvillohej, si në aspektin legal dhe atë operacional. Shoqata u rrit dhe u zhvillua duke jetësuar në punën e saj, praktikat më të mira ndërkombëtare të punës së Kryqit të Kuq të ofruara nga delegacioni i Federatës. Në këtë mënyrë, kjo, nuk kishte se si të mos reflektonte në arritjet e saj. Shoqata është formatuar në jetën e saj të brendshme sipas këtij modeli duke u strukturuar, në nivel lokal dhe në nivel qendror, në organe të zgjedhura, thënë ndryshe *governancë*, të cilat drejtojnë shoqatën dhe në organe të emëruara, thënë ndryshe, *menaxhim*, të cilat merren me organizimin e punëve të përditshme të shoqatës.

Një organizim i tillë i punës, përfshi këtu dhe përkushtimin e vazhdueshëm të vullnetarëve dhe të stafit të shoqatës, ka bërë që të mos mungojnë dhe rezultatet në punë dhe vlerësimet edhe në nivel ndërkombëtar. Kështu, në vitin 2004, KKSH u vlerësua nga Federata si një “Shoqatë që funksionon mirë”, gjë që do të thotë se shoqata kombëtare jo vetëm është e organizuar dhe punon me përkushtim për përmbushjen e misionit të saj humanitar në vend, por ajo përmbush disa kushte të vendosura nga Federata për të merituar vlerësimin *si një shoqatë që funksionon mirë*, duke bërë në mënyrën e duhur atë që duhet. Ky vlerësim përbën njohjen në nivel ndërkombëtar të mundit e kontributit të të gjithë vullnetarëve dhe stafit të shoqatës dhe për këtë të gjithë ndihemi krenarë.

Shoqata vazhdon çdo vit në rrugën që ajo i ka përcaktuar vetes, në respekt të Parimeve Themelore të Lëvizjes dhe duke përmbushur të gjitha detyrimet e saj. Nuk kaloi shumë kohë dhe në janar të këtij viti, KKSH u njoh me një vlerësim tjetër nga ana e Federatës, atë të përfshirjes së saj në grupin e 50 Shoqatave kombëtare të KK dhe GjK më të mira të globit. Ky vazhdimi faqe 7

8 Maj - Dita Botërore e Kryqit të

Kryqi i Kuq Shqiptar e kremton atë me dy veprimtari kombëtare: Konkursin Kombëtar

Konkursi XIX Kombëtar i Ndihmës së Parë.

Ka plot 19 vjet që Kryqi i Kuq Shqiptar, zhvillon Konkursin Kombëtar të Ndihmës së Parë.

Edhe për 2017-n u ndoq e njëjta formë organizimi në tre faza: fillimisht të gjitha degët ngritën grupet dhe u përgatitën gjatë muajve janar-shkurt, pastaj në muajin mars u zhvilluan konkurset nëpër degë, ku 18 degë u paraqitën me 2-3 grupe vullnetarësh, 10 degë u paraqitën me 4 grupe vullnetarësh, 9 degë u paraqitën me 5-6 grupe vullnetarësh dhe dega Tiranë u paraqit me 11 grupe vullnetarësh; mandej në muajin prill u zhvilluan 3 konkurset rajonale (Shkodër, Durrës dhe Fier) dhe në fund u mbyll me takimin final në 8 Maj në Tiranë, pra në ditën botërore të Kryqit të Kuq. Në të tre nivelet e konkurrimit u përgatitën stacione demonstrimi me aksidente e viktime si dhe simulimi për raste aksidentesh.


Konkursi kombëtar nuk është më vetëm një aktivitet tradicional tashmë, por një aktivitet me përmasa siç ka emrin Kombëtar dhe në këtë shkrim po japim disa risi dhe arsye përse është i tillë. Aktiviteti ka dy drejtime kryesore pse zhvillohet:



- Përgatitjet e bëra gjatë vitit, trajnimet e vullnetarëve të rinj “ të matin forcën” dhe të konkurojnë ndërmjet degëve për mënyrën si e sa i njohin njohuritë për ndihmën e parë dhe si i zbatojnë praktikisht metodat e dhënies së ndihmës së parë.
- Ndërgjegjësimi i gjerë i komunitetit, mbasi konkurset zhvillohen në qendër të qyteteve të degëve, për rëndësinë që kanë njohuritë e ndihmës së parë, për t'i mësuar dhe praktikuar nga kushdo, mbasi

gjithsecili mund të ndodhet në një situatë të tillë që personi të jetë në rolin e dhënësit të ndihmës së parë në ndihmë të një personi të lënduar.

Të dyja këto drejtime bashkohen në moton “Ndihma e Parë shpëton Jetë!”



Siç e përmendëm më sipër, është një eksperiencë 19 vjeçare, ku shoqata në vite, ka sjellë risi në mënyrën e organizimit, përfshirjen e degëve, larminë e grupmoshave etj, duke bërë që ky aktivitet të jetë më masiv që organizon Shoqata në dy kuptime:

- në veprimtari përfshihen të gjitha degët e KKSHT, të gjithë vullnetarët më aktivë të çdo dege, rreth 1000 vullnetarë, instruktorë e të zgjedhur.
- konkursi ka një shtrirje prej katër muaj, deri në 8 maj, ku kulmon me takimin final të konkursit në kryeqytet.

Standardi i zhvillimit të Konkursit të Ndihmës së Parë, është perfeksionuar në vazhdimësi falë eksperiencës së fituar, por dhe pjesëmarrjen e ekipit kombëtar në Konkursin Europian të Ndihmës së Parë. Në vitin 2016, ekipi ynë u rendit i dhjeti ndër 28 ekipe të shoqatave simotra. Natyrisht kemi pasqyruar edhe të rejat që ka referuar Qendra Globale e

Referencave për Edukimin e Ndihmës së Parë.

Një komponent tjetër që i kemi kushtuar rëndësi është dhe cilësia e kryerjen së aktivitetit. Ky aspekt është parë si një tregues që reflekton të gjithë etapën e zhvillimit të tij, duke filluar me përgatitjeve në nivel dege (angazhimi dhe motivimi i vullnetarëve më aktivë), zhvillimi sa më profesional i konkursit në të gjitha degët KKSHT; pjesëmarrja sa më dinjtoze në nivel rajonal, shoqëruar kjo me ambicien për të dalë fitimtar si ekip dhe marrë një nga çmimet fituese të konkursit.

Natyrshtëm, zhvillimi i këtij konkursi, rrit imazhin dhe vizibilitetin e Shoqatës në sy të institucioneve dhe komunitetit në tërësi. Ekipet, e veshura me uniformën e KKSHT me logo, bazën materiale të domosdoshme, banderolat dhe posterat e afishuara kryesisht në qendrat e qyteteve, bëjnë atë që të tërheqin vëmendjen dhe interesin e kujtdo që ndodhet rastësisht apo ardhur posaçërisht për të ndjekur këtë aktivitet të degës, rajonal apo kombëta. Veprimtaria ka tërheq vëmendje dhe ka gjetur pasqyrim në median lokale dhe atë qendrore. Një pasqyrim më i gjerë i saj është bërë në media sociale në degë dhe në Selinë e KKSHT.

Pra kontakti i Shoqatës nëpërmjet këtij aktiviteti drejtpërdrejt apo nëpërmjet rrjeteve sociale, shton edhe më tej vlerat dhe përçon parimet tek njerëzit, të cilët nesër do të jenë anëtarë, vullnetarë dhe pse jo pjesë aktive e aktiviteve të KKSHT.

Fatos Xhengo

Koordinator i Programit të Përgatitjes dhe ndërhyjes në raste katastrofash dhe Ndihmën e Parë

Ekipet fituese të Konkursit të XIX Kombëtar të Ndihmës së Parë:

- Vendi Parë - Dega KK Tiranë
- Vendi i Dytë - Dega KK Fier
- Vendi Tretë - Dega KK Shkodër.

Kuq dhe e Gjysmëhënës së Kuqe

të Ndhmës së Parë dhe Ekspozitën Kombëtare të vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq"

Ekspozita XXI Kombëtare "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq"

8 Maji, ditëlindja e themeluesit të Kryqit të Kuq, Henry Dunant, njëkohësisht Dita Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, kremtohet nga Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSJ) dhe nëpërmjet dy veprimtarive: Fushata sensibilizuese për vlerat humanitare dhe Konkursi i vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq" që finalizohet me Ekspozitën Kombëtare të Vizatimit në Tiranë.

Fushata sensibilizuese për promovimin e vlerave humanitare është një komponentë i rëndësishëm i kësaj veprimtarie. Ajo kërkon nga njëra anë angazhimin e të rinjve vullnetarë të KK, të nxënësve të shkollave 9-vjeçare, të Drejtorive Arsimore dhe të mësuesve të lëndës së vizatimit, të stafit të degëve të KK si mbështetës dhe orientues në këtë projekt. Të gjithë këto elementë bashkëpunojnë në realizimin e qëllimit të projektit për të përfshirë sa më shumë nxënës dhe vullnetarë në përhapjen e vlerave humanitare të KK të bashkëmoshatarët e tyre. Bashkëpunimi i KKSJ me Drejtoritë Arsimore u jep mundësi shkollave të jenë të hapura për realizimin e seancave sensibilizuese mbi Kryqin e Kuq, dhe më pas organizimin e Konkursit të Vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq".



Grupi shenjë në këtë projekt janë nxënësit e shkollave 9-vjeçare sot, nesër vullnetarë të KK. Nëpërmjet seancave sensibilizuese, nxënësit mësojnë jo vetëm mbi Kryqin e Kuq si shoqatë humanitare, misioni i të cilit është të të ndihmojë njerëzit në nevojë në çdo kohë, dhe t'i nxisë ata, nxënësit që të marrin dijet dhe nxitjet e nevojshme për të qenë nesër, vullnetarët e ardhshëm të kësaj shoqate. Si rezultat i zhvillimit të

një fushate intensive, për një periudhë katër mujore: në 231 shkolla 9-vjeçare, janë zhvilluar 300 seanca sensibilizuese në 12 degë të KK të kategorisë së parë. Në realizimin e tyre u angazhuan 200 të rinj vullnetarë. Në veprimtaritë e projektit morën pjesë rreth 25.000



nxënësve, prej nga u paraqitën rreth 3000 punime që pasqyrojnë vlerat e Kryqit të Kuq nëpërmjet gjuhës së artit, punimeve kryesisht në vizatim të nxënësve. Në punimet e tyre, nxënësit reflektojnë vlerat themelore humanitare të kësaj Levije të madhe mbarë botërore si vullnetarizmi, humanizmi, ndjenja e solidaritetit, etj.

Këtë vit fushata për promovimin e vlerave humanitare dhe konkurset e vizatimit u zhvilluan në 38 degë. Në 38 degët u hapën ekspozita me punimet e nxënësve, të cilat u vizituan veçanërisht nga bashkëmoshatarët e tyre, mësuesit dhe prindërit, por dhe nga përfaqësues të pushtetit vendor dhe atij qendror.

Nga punimet e paraqitura në ekspozita u vu re pasqyrimi në to i veprimtarive të KKSJ, veprimtari që shumë nga nxënësit i kishin parë të ndodhnin në zonat e tyre siç janë: ndihma e KK për familjet në nevojë gjatë dimrit të ashpër të këtij viti,

dhurimi vullnetar i gjakut, si një akt human për të shpëtuar jetë, ndihma që vetë fëmijët kanë dhënë për të ndihmuar njerëzit në nevojë, etj

E gjithë kjo fushatë sensibilizuese u përmyll me organizimin në Tiranë të Ekspozitës XXI Kombëtare të Vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq". Në këtë ekspozitë u paraqitën rreth 300 punimet më të mira fituese të 38 ekspozitave të organizuara nga degët e KK.

Ekspozita u organizua në ambientet e Hotel "PLAZA". Punimet e përzgjedhura, pasqyrojnë me vërtetësi veprimtaritë humanitare të shoqatës në forma dhe teknika të ndryshme artistike nga nxënësit.

Gjithashtu, Digitalb, Agna Group dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit mbështetën zhvillimin e kësaj ekspozite. Ekspozita u vizitua nga shumë dashamirës, prindër të fëmijëve, përfaqësues të ambasadave të huaja, përfaqësues të pushtetit vendor e qendror e vullnetarë të KK. Ajo u pasqyrua gjerësisht në median qendrore të vendit.

*Manjola Sykneja
Koordinatorë e Programit të
Rinisë dhe Promovimit të
Vlerave Humanitare*

Çmimet për Ekspozitën XXI Kombëtare të vizatimit "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq"

- Tedi Killo, Çmimi i Tretë, Shkolla "Drita e Dijes", Dega KK Berat;
- Emanuel Delia, Çmimi i Tretë, Shkolla "Pjetër Arbënor", Dega KK Pukë;
- Sindi Ramaj, Çmimi i Tretë, Shkolla "Avni Rustemi", Dega KK Vlorë;
- Joan Mato, Çmimi i Dytë, Shkolla "Gjok Shqiptari", Dega KK Pogradec;
- Veronika Lloha, Çmimi i dytë, Shkolla "Emin Duraku", Dega KK Tiranë;
- Tomas Pecini, Çmimi i Parë, Shkolla "Jani Bakalli", Dega KK Fier;

Asnjë nuk e di se kush, ku dhe kur do të ketë nevojë për ndihmë të parë, por të gjithë e dimë që ndihma e parë duhet ti jepet çdo kujt, në çdo vend e në çdo kohë.

Përveç se është një fushë tradicionale veprimi e të gjitha Shoqatave të Kryqit të Kuq (KK) dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (GjK) në botë, është dhe një direktivë e Këshillit të Europës, që sugjeron se në vendet anëtare dhe vendet candidate duhet, që grupet më në risk dhe grupet e interesit sic janë drejtuesit e automjeteve, vecanërisht kandidatët për t'u pajisur me leje drejtimi të dinë si të sillen në raste aksidentesh, të dinë si të japin Ndhimën e Parë për të lënduarit nga aksidentet e ndodhura në rrugë. Në vendit tonë, këto shifra janë mjaft të larta. Në vit humbin jetën 265 persona, 369 persona mbeten të lënduar rëndë dhe 1992 persona mbeten të lënduar lehtë vetëm si pasojë e aksidenteve automobilistike. Në këto kushte zbatimi i kësaj direktive të këshillit të Europës kthehet në një domosdoshmëri.

Të gjitha këto kanë bërë që Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH) ta konsiderojë Shërbimin e Trajnimit për Ndhimën Parë jo vetëm si një drejtim bazë të veprimtarisë së Shoqatës, dhe veçanërisht si një shërbim për grupet shenjë më të rrezikuara, duke rritur kapacitetet njerëzore e materiale për përgatitjen dhe zhvillimin e kurseve të ndryshme të Ndhimës së Parë për kandidatët për drejtues automjeti dhe ato për sipërmarrjet private e shtetërore të prodhimit e ndërtimit me qëllim krijimin e bërthamës të dhënësve të ndihmës së parë në këto institucione, etj.

Programi i Ndhimës së Parë i KKSH e ka filluar veprimtarinë e tij me rifillimi e tij në vitin 1990 dhe është riorganizuar i plotë në vitin 1994, dhe vit pas viti ka rritur kapacitetet e tij materiale e njerëzore me qëllim krijimin e një rrjeti të gjerë instruktorësh dhe vullnetarësh të specializuar në të gjithë vendin (KKSH e shtinë veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet 39 Degëve të Kryqit të Kuq në qytet kryesore të tij).

Për realizimin e këtyre kurseve

me cilësi për grupe të ndryshme është dashur kohë, pasion dhe mund. Vetëm në vitin 2005, dhjetë vjet pas organizimit të Programi të Ndhimës së Parë, është bërë e mundur fillimi i zhvillimit të kurseve të trajnimit për kandidatët për drejtues automjeti, e më vonë dhe kurset e tjera grupet të ndryshme shenjë si punonjësit e kompanive të ndërtimit, fasoneritë, biznese etj.

Zhvillimi i këtyre kurseve ka kërkuar gjithashtu dhe përmirësimin e bazës ligjore mbi të cilat ato do të zhvillohen. Zhvillimi i këtyre kurseve u sanksionua me **Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" dhe ndryshimet që ka pësuar ky ligj me nr. 8738, datë 12.2.2001; ligjin nr. 9189, datë 12.2.2004; ligjin nr. 9808, datë 24.9.2007; vendimin e GJK nr. 12, datë 14.4.2010; ligjin nr. 10488, datë 5.12.2011, që kanë gjetur mëshirim në marrëveshjen 3 palëshe ndërmjet KKSH, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, "Për organizimin e Kursit të Trajnimit për Dhënien e Ndhimës së Shpejtë Mjekësore në Rast Aksidenti Rrugor", datë 20.03.2012.**

Puna e madhe për krijimin e kapaciteteve u shpërblye në vitin 2008 me licencimin në KKSH nga Qendra Europiane e Referencave për Ndhimën e Parë, çka tregon që shërbimet e ofruara nga KKSH – kurset e Ndhimës së parë për grupe të ndryshme shenjë ofrohen sipas standardit të këtij institucioni ndërkombëtar.

Ngritja e një programi për shërbimin e Ndhimës së Parë është mbështetur në eksperiencat e shoqatave

simotra të KK Danez, KK Austriak, KK Gjerman, KK Slloven, KK Bullgar, KK Zvicër, KK Islandë, KK Lituani, KK Poloni, KK Rumun, Gjysmëhëna Turke, KK Serbi, KK Mali i Zi, etj, të cilat kryejnë shërbim të ngjashëm në vendet e tyre respektive për këto kategori për të cilat Kryqi i Kuq Shqiptar ofron aktualisht shërbimin.

Dy janë drejtimet kryesore të programit:

Drejtimi 1: Të realizohet me profesionalizëm shërbimi i trajnimit të ndihmës së parë me kandidatët për drejtues automjeti.

Drejtimi 2: Ofrimi dhe zhvillimi i kurseve të ndihmës së parë për kompani private ndërtimi dhe prodhimi, firma, institucione, OJF, studentë të fakultetit të mjekësisë, publiku i gjerë dhe grupe shenjë në rrezik.

Edhe për këtë periudhë është punuar në të dy drejtimet. Konkretisht për shërbimin e trajnimit dhe zhvillimit të kurseve me kandidatët drejtues automjeti, janë trajnuar dhe pajisur me dëshmi të ndihmës së parë 16 604 persona, shifër kjo edhe për shkak të një fluksi për stinën e verës dhe rritjes së kërkesës për zhvillimin e kursit të trajnimit.

Mbi zhvillimin e kurseve në institucione (Ligji nr. 10 053, datë 29.12.2008, neni 75; Urdhri Nr. 82, datë 22.02.2011, publikuar në faqen zyrtare të Republikës së Shqipërisë), puna është intensifikuar më tepër pranë kompanive prodhuese dhe subjekteve private të shërbimit (hoteleri etj). Për këtë periudhë 330 persona kanë ndjekur trajnimin dhe janë pajisur me certifikatë.

Kryqi i Kuq Shqiptar ofron shërbimin e trajnimit të Ndhimës së Parë për këto grupe shenjë:

- Kandidatët drejtues automjeti	programi	8 orë
- Trajnim për punonjësit e institucioneve private dhe shtetërore, kompani, subjekte, publikun	programi	7 orë
- Kurse trajnimi për vullnetarët e KKSH	programi	12 orë



Vazhdimisht programi punon për unifikimin dhe rritjen e standardit të mësimdhënies në të gjitha degët KSSH nëpërmjet rifreskimit të njohurive dhe formave të tjera..

Me qëllim rritjen cilësore dhe unifikimin e shërbimit të trajnimit të ndihmës së parë, nga data 3-10 korrik u zhvillua testimi kombëtar i instruktorëve të ndihmës së parë. Testimi kishte dy nivele të matjes së njohurive, teorik dhe praktik, sipas standardit të Qendrës Globale të Referencave për Ndihmën e Parë:

- Testi teorik, i përgatitur mbi bazën e gjithë metodës pedagogjike dhe udhëzimit mbi zhvillimin e kurseve të ndihmës së parë me kandidatët drejtues automjeti;
- Praktika e mësimdhënies, zhvillimi i një ore mësimi sipas metodës dhe standardit të Qendrës Globale të Referencave për Ndihmën e Parë.

Në testim morën pjesë 89 instruktorë të ndihmës së parë, rezultatet konkrete:

- 48 instruktorë u kualifikuan,
- 32 instruktorë kanë nevojë për kurs rifreskimi
- 9 instruktorë nuk e kaluan testin.

Për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe zbatimin korrekt të Rregullores për të gjithë procedurën e kryerjes së këtij shërbimi në të gjitha degët ku zhvillohen kurset e trajnimit të ndihmës së parë kryesisht me kandidatët drejtues automjeti, KSSH ka instaluar një sistem monitorimi online me kamera aktualisht në 20 degë. Pjesë e këtij procesi mbetet dhe ndjekja e drejtpërdrejtë e zhvillimit të kurseve në degë në zbatim të një grafiku të detajuar mujor.

Luljeta Hidi
Koordinatorë e Programit
Shërbimi për Ndihmën e Parë



vlerësim u bë mbi bazën e disa kriterëve të përcaktuara më herët nga Federata dhe të bëra me dije për 190 shoqatat kombëtare në botë. Ky lloj vlerësimi nuk ngjan me ato që bëhen në veprimtari të ndryshme, kryesisht sportive, por dhe jo vetëm, ku përcaktohet nominalisht vendi i vlerësuar. Ky vlerësim ka si qëllim identifikimin e shoqatave kombëtare më të mira, duke i motivuar ato më tej në punën e tyre dhe, nga ana tjetër, nxit shoqatat e tjera kombëtare që të shtojnë përpjekjet e tyre për të performuar më mirë. Nëse do ta perifrazonim këtë vlerësim, do të thotë që mund të mos jemi të parët në renditje, mund të mos jemi as të fundit, mund të jemi diku nga mesi, por rëndësi ka që jemi të mirëvlerësuar në atë që jemi e për atë që bëjmë.

Përpara 25 vjetësh KSSH rilindi. Me përpjekjet e tij dhe me mbështetjen e Federatës, shoqata arriti që në vitin 2017 të përfshihet në grupin e 50 Shoqatave Kombëtare të KK dhe GJK më të mira të globit. Rrugëtimi prej çerek shekulli solli ekzistencën e një shoqate kombëtare, që në fillimet e saj nuk e kishte përfytyruar kurrë që pas kaq vitesh të renditej në këtë nivel.

Arritje të tilla nuk janë të rastësishme por, nga ana tjetër, kjo tregon se kur punohet me pasion dhe dëshirë për arritjen e një qëllimi të caktuar, vlerësimi vjen vetë, edhe pse shoqata nuk e ka pasur asnjë herë qëllim në vetvete këtë në objektivat e synimet e saj.

Federata ka treguar ndaj KSSH përkujdesin e një prindi ndaj fëmijës. Ajo e ka ndihmuar shumë atë dhe nga kjo ndihmë kanë përfituar si shoqata por edhe me dhjetra e qindra mijëra nevojtarë në vend gjatë këtij çerek shekulli. Ashtu si prindi që nuk kërkon shpërblim material nga fëmija për përkujdesin e treguar në rritjen e tij, edhe Federata nuk e ka një pritshmëri të tillë. Në këto raste, shpërblimi më i madh i shoqatës ndaj Federatës është puna dhe përkushtimi për përmbushjen e misionit. Andaj, mendoj se ky vlerësim që shoqata ka marrë, është njëkohësisht edhe një shprehje respekti, falënderimi dhe mirënjohje për kontributin e Federatës ndaj KSSH në rrjedhën e këtyre viteve.

Integrimi i gruas në tregun e punës

Në botë, rreth 98 milionë vajza nuk shkojnë në shkollë, dhe shumë prej tyre nuk e kanë të lehtë të gjejnë punë, për arsye të pozitës inferiore në të cilën gjenden në shoqëri. Veçanërisht, pabarazia gjinore vazhdon të jetë një fenomen në mbarë botën, veçanërisht në vendet në zhvillim. Pikërisht kjo pabarazi, i privon gratë dhe vajzat nga të drejtat e tyre qytetare për të marrin dhe luajtur rolin që u takon në shoqëri. Diskriminimi mbi baza gjinore rezulton shpesh si pasojë e qëndrimeve patriarkale dhe normave aspak të drejta shoqërore të një vendi.

Një dukuri e tillë vihet re dhe në vendin tonë, në mënyrë të veçantë në zonat rurale, ku gruaja e ka të vështirë që të gjej veten, dhe të marrë në dorë fatet e vetes dhe të familjes, për më tepër kur rrethanat e jetës e vendosin përpara sfidave të vështira. Arritja e barazisë gjinore dhe forcimi i rolit të grave dhe vajzave kërkon përpjekje më të fuqishme, veçanërisht në praktikën e përditëshme dhe atë ligjore.

Ishte kjo arsyeja që "Objektivat e zhvillimit të Qëndrueshëm", të marra nga Kombeve të Bashkuara synojnë të inkurajojnë institucionet në mbarë botën që "të arrijnë barazinë gjinore dhe të forcojnë rolin e grave dhe vajzave në shoqëri". Me gjithë përpjekjet e bëra dhe masat e marra në dekadën e fundit, situata e përgjithshme dhe pozicioni i grave në Shqipëri, ka shumë vend për përmirësime.

Pikërisht kësaj iniciative dhe sfidave që kërkon koha në këtë drejtim

i është bashkangjitur dhe Kryqi i Kuq Shqiptar. Prej më e 10 vitesh, shoqata realizon zbatimin e projektit "Integrimi i gruas në tregun e punës". Ky projekt është realizuar dhe vazhdon të realizohet në disa degë të tij si në Degën e KK Korçë, Berat, Lezhë, Tiranë e Shkodër. Janë kryesisht kurse rrobaqepësie dhe kohët e fudnit dhe kursi i gatimit në degën e KK Tiranë që ofrohen falas për vajza dhe gra në nevojë, me qëllim mësimin prej tyre të një profesioni dhe punësimin nesër në tregun e punës.

Prej dy vjetësh, një kurs i tillë është hapur dhe ka filluar të funksionojë në Degën e KK Berat falë mbështetjes financiare të Ambasadës Franceze në vendin tonë.

Projektit ka për qëllim të kontribuojë në fuqizimin e grave dhe vajzave në rrethin e Beratit duke u mundësuar mjetet e nevojshme për të rritur e forcuar aftësitë e tyre profesionale dhe personale, me qëllim lehtësimin e punësimit të tyre, dhe forcimit të pozitës së tyre sociale brenda familjes dhe në komunitetet ku jetojnë. Projekti synon të përmirësojë dy aspekte të situatës aktualë ku gjenden gratë:

- Aspektin ekonomik: njihet fakti që të ardhurat e grave janë të kufizuara. Veçanërisht gratë që jetojnë në zonat rurale, kanë pak mundësi për arsimin dhe trajnimin profesional. Punësimi



tek gratë shqiptare kufizohet nga disa faktorë si obligimi dhe përgjegjësitë e tyre për fëmijët dhe punët e shtëpisë, edukimi arsimor dhe profesional i kufizuar, etj. Pikërisht për këtë KK mendon se përmirësimi i aftësive profesionale nëpërmjet kurseve të rrobaqepësisë dhe punësimit të tyre, sjellë përmirësim të drejtpërdrejtë të kushteve ekonomike të grave dhe të familjeve të tyre, duke qenë kështu një garanci për forcimin e rolit të grave, përfituese të projektit.

- Aspekti social: gratë shqiptare kanë një status social më të ulët në krahasim me burrat. Shumë gra qëndrojnë në shtëpi, e për pasojë kanë mungesë kontakti me shoqërinë. Veçanërisht në zonat rurale të vendit, roli e femrës si grua dhe si nënë, është i fokusuar vetëm në përmbushjen e nevojave të anëtarëve të tjerë të familjes. Në këtë kontekst, përfituesve të projektit ju ofrohet mbështetje psiko-sociale, me qëllimin rritjen e vetë-vlerësimit për personalitetin e tyre dhe forcimit të rolit të tyre në familje.

Në përfundim të këtij projekti:

- 30 përfituese përfunduan me sukses kursin 6-mujor, dhe u certifikuan në fushën e rrobaqepësisë;
- 14 përfituese janë punësuar në kompani private, falë ndërmjetësimit të Degës së KK Berat;
- 10 përfituese janë vetë-punësuar
- 6 përfituese janë në pritje të punësimit





Fushata për mbledhje fondesh Maj-Qershor



Në ndihmë të veprimtarive sociale të zhvilluara nga Programi Social janë dhe fushatat publike që kanë si qëllim jo vetëm sensibilizimin e publikut dhe rritjen e ndjenjës së solidaritetit në mbështetje të njerëzve në nevojë, që luftojnë çdo ditë për të kapërcyer problemet me varfërinë, punësimin, edukimin, dhunën, por në radhë të parë sigurimin e të ardhurave në ndihmë të tyre.

Fushata për mbledhje fondesh, e realizuara në muajt **Maj-Qershor** kishte në fokus **“Fëmijët në nevojë”**. Dhe dita kulmore e kësaj fushate ishte **1 Qershori**, Dita Ndërkombëtare e fëmijëve. Në këtë ditë degë të KK realizuan një sërë aktiviteteve sensibilizuese, mbështetëse dhe argëtuese për fëmijët në vështirësi. Falë fondeve të mbledhura në këtë fushatë u ndihmuan rreth 660 fëmijë në nevojë dhe familjet e tyre. Më poshtë shifrat sipas degëve.

	Degët	Numri fëmijëve
1	Tirana	189
2	Lezha	132
3	Korça	75
4	Vlora	50
5	Berat	45
6	Lushnje	49
7	Kucove	27
8	Gramsh	20
9	Durres	20
10	Elbasan	21
11	Diber	30

Një histori suksesit nga Projekti “Integrimi i Gruas në Tregun e Punës”, Dega e KK Berat.

Një nga vajzat, përfituese e këtij projekti është edhe Dorina S., një vajzë pjesë e komunitetit egjiptian, e cila ka arritur të përfundojë vetëm arsimin 9 vjeçar. Prindërit e Dorinës janë të dy përfitues të një pensioni invaliditeti për shkak të gjendjes shëndetësore jo të mirë. Dorina që në moshë shumë të vogël, jeton me gjyshen e saj, e cila vetë është e moshuar dhe ka nevojë për përkujdesje.

Gjatë kohës së ndjekjes së kursit, Dorina përveç mësimin shumë të mirë të profesionit të rrobaqepësisë, krijoi dhe lidhje shumë të mira shoqërore me vajzat dhe gratë e tjera të kursit.

Në fillim një vajzë shumë e ndrojtur për faktin se nuk kishte pasur asnjë mundësi të mëparshme socializmi, gjatë zhvillimit të projektit, arriti të krijojë marrëdhënie shumë të mira shoqërore me gratë e vajzat dhe me stafin e projektit.

Psikologja e qendrës tonë e vlerëson si një vajzë shumë të edukuar, që përshtatet lehtë me njerëzit dhe ambientin që e rrethon, dhe me ambicie për jetën. Ajo është një vajzë që ka dashur gjithmonë të ketë mundësi të mësojë dhe të krijojë shoqëri, gjë

të cilën e arriti mjaft mirë nëpërmjet pjesëmarrjes në këtë projekt.

Me përfundimin e projektit, Dorina u punësua në Fabrikën e prodhimit të veshjeve MARLOTEX, në të cilën nuk kishte arritur të punësohet më parë për shkak të mungesës së aftësive profesionale. Gjetja e një pune, do të thoshte për të dhe një shoqëri e re dhe një shoqërim më i mirë i saj.

Pjesëmarrja në këtë projekt për Dorinën, ishte shumë e rëndësishme se përveç faktit që ky projekt i dhuroi një profesion të certifikuar, dhe e ndihmoi të gjente një vend pune, ajo ndjehet falë tij e forcuar si individ, që vlerëson veten dhe të tjerët dhe të mund të krijojte marrëdhënie të mira sociale.

Stafi i Degës së KK Berat, është shumë i lumtur që nëpërmjet përkushtimit dhe ndërmjetësimit pranë biznesit, arritën të bëjnë realitet ëndrrën e Dorinës, dhe të shumë vajzave tjera si ajo.

Zhaneta Kala, Koordinatore e Programit Social



14 Qershori, Dita Botërore e Dhuruesve Vullnetarë të Gjaket


Në fund të viteve '70, i sapo diplomuar dhe plot ëndrra e ambicie për të qenë mjek i zoti dhe njeri i mirë, fillova punë në një zonë të thellë të vendit, ku në secilin fshat të saj ishin më shumë se dy familje të prekur nga talasemia. Në nëntë fshatra të zonës që mbuloja ishin më shumë se 35 të sëmurë talasemikë. Me kolegun tim më të madh në moshë, kishim përgjegjësinë të mbulonim tërësinë e problematikave mjekësore, të një popullsie prej disa mijëra personave, por përbalja me pacientët talasemikë të të gjitha moshave, ishte tepër e vështirë. Ishte një përballje me vuajtjen njerëzore, me thirrjen për ndihmë për lehtësimin e dhimbjeve të mëdha që paraqisnin gjatë krizave, ishte ballafaqim me vështirësitë e zgjidhjes imediate, për përmirësim e lehtësim, që për t'u realizua kërkonte transfuzion gjaku në spitale. Shto këtu dhe mjerimin ekonomik, numrin prej disa të sëmurësh talasemikë në të njëjtën familje, infrastrukturën e mangët dhe mjetet e pakta mjekësore në dispozicion, dhe kuptohet dëshpërimi i familjarëve dhe i mjekut. Ky ishte pozicionimi i parë me të cilin u njoha me të sëmurët në nevojë kronike për gjak.

Kaluan vite dhe pata fatin të drejtoja Pavionin e Patologjisë në Spitalin e Lushnjës; pikërisht të atij rrethi ku gjenden numri më i madh i të sëmurëve talasemikë në vend, dhe ku kurimi i talasemikëve zë një vend të veçantë. Tashmë nuk isha mjeku që lutej për t'i shtruar në spital për t'i kuruar këta pacientë, por mjeku që kishte përgjegjësinë e kurimit spitalor e që së bashku me kolegë të tjerë, duhej t'u siguronim "Gjakun" të cilin po e shkruaj me garmë të madhe, për të treguar se ai dhe kryesisht ai "Gjaku" do t'u hiqte dhimbjet, do t'u përmirësonte shëndetin dhe do t'u mundësonte një jetë normale. Ky ishte pozicioni i dytë me të cilin u njoha me të sëmurët në nevojë për gjak dhe me vështirësitë për të siguruar gjak kur duhej dhe në sasi të nevojshme.

Vitet kaluan. Për rastësi apo për zgjedhjen time, përsëri m'u desh t'i shoh nevojat për gjak, tashmë nga një pozicion

i tretë; tashmë jo vetëm për talasemikët, por për këdo pacient (talasemikë, të aksidentuar, gra në lindje, individë në operacione etj.) dhe jo si mjek kurues, por si pjesëtar i shoqatës më të madhe humanitare në vend, Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSJ) e ku ndjehem i nderuar, që më është besuar të jem pjesë e Programit të promovimit të dhurimit vullnetar të gjakut.

Deri këtu përmenda nevojat për gjak, që sa vijnë e rriten, por prapa gjakut kaq të nevojshëm qëndrojnë të heshtur, por tepër njerëzor, ata individë me zemër të madhe, altruistë



e fisnikë, heronjë, që thjesht mbajnë emrin "Dhurues Vullnetarë të Gjaket". Me vullnet të lirë e të ndërgjegjësuar, që gjaku i tyre, lehtëson vuajtjen dhe shpëton jetë njerëzish, të cilët as nuk i njohin, shfaqin gatishmërinë për të dhuruar gjak.

Në mirënjohjet e aktit të tyre human, si dhe ndërgjegjësimit të popullatës për të pasur sa më shumë dhurues vullnetarë të gjakut, lindi natyrshëm 14 Qershori, Dita Botërore e Dhuruesve Vullnetar të Gjaket, e caktuar si e tillë në vitin 2004. Anë e mbanë botës vende të ndryshme shënojnë këtë ditë, me larmi veprimtarish, ku përfshihen mijëra e mijëra dhurues vullnetarë që shtojnë radhët e tyre me të tjerë vullnetarë. Këtu bën pjesë dhe vendi

ynë, dhe veçanërisht KKSJ, që ka një rol të rëndësishëm në promovimin, rekrutimin e dhuruesve të rinj dhe orga-nizimin e seancave të dhurimit vullnetar të gjakut.

Janë bërë më shumë se 10 vite, që kur KKSJ, nëpërmjet vullnetarëve të Programit të Shëndetit, ka nisur përpjekjet për ndërgjegjësimin e indivi-dëve, grupeve të caktuara dhe komunitetin në përgjithësi, për humanizmin që mbart akti i dhurimit vullnetar të gjakut, për nevojat ekstreme për gjak, për faktin se gjaku i dhuruar është gjak i sigurt, për dhimbjet që lehtëson, për shpresat që jep, për jetët që shpëton, për të mirat psikologjike, shpirtërore e shëndetësore, që ka dhurimi vullnetar i gjakut dhe për vetë dhuruesit.

Të gjitha degët e KKSJ, promovojnë dhurimin vullnetar të gjakut duke nxitur popullatën të dhurojë gjak vullnetarisht, organizojnë seancat e dhurimit vullnetar të gjakut në bashkëpunim me QKTGJ. Vullnetarët tanë punojnë çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, gjithë vitin, veprimtari këto që kulmojnë më 14 Qershor, në Ditën Botërore të Dhuruesve Vullnetarë të Gjaket.

Të rëndësishme dhe me ndikim në rezultate kanë qenë informacionet e dhëna, profesionalizmi dhe mënyrat me vijon në faqen 18



Intervista jonë – Me ambasadorin e dëshirës së mirë të Kryqit të Kuq Danez Thorbjorn Pedersen



Torbjørn C. Pedersen, që miqtë e thërresin thjesht Thor, është një danez 38 vjeçar, që e ka nisur udhëtimin e tij rreth botës në vitin 2013. Njëzet dollarë në ditë dhe asnjë fluturim për të vizituar të gjitha vendet e planetit. Ky është objektivi që i ka vënë vetes.

“Një i panjohur është një mik, që ti akoma nuk e ke takuar akoma”. Kujtoja se ishte thjesht një fjalë e mirë, por tani që kam jam bërë dëshmitar i qindra e qindra njohjeve fantastike, dëshiroj të jap vetëm një mesazh: njerëzit gjithkund janë jashtëzakonisht bujar, mjafton t’u japësh atyre mundësitë për ta dëshmuar këtë”- thotë Thor.

Një çantë në kurriz, dhe me një shikimi mjaft të ëmbël dhe të qeshur, ky është Torbjørn C. Pedersen, që ka nisur udhëtimin e tij nga Kopenhagen në orën 10 e 10 të datës 10 tetor 2013, për të vizituar jo pak por 203, për të paktën 24 orën në secilin prej tyre. Udhëtim që pritet të përfundojë në vitin 2019.

Ambasador i dëshirës së mirë i Kryqit të Kuq Danez, Thor, është me profesion ekspert logjistike. Në të gjitha vendet që ka shkuar ai është mikpritur nga shoqatat vendase të Kryqit të Kuq apo të Gjysmëhënës së Kuqe.

Intervista :

Përpara se të ndërmerrenit këtë nismë, e keni diskutuar me miq dhe të afërm?

Sigurisht që e kam bërë. Babai im ishte tërësisht kundër. Më këshilloi të mos e bëja. Ai më tha se kështu do të shkatërroja jetën dhe karrierën time,

ndërsa nëna nuk u habit aspak, sepse ajo është një udhërrëfyese (guide). Ajo thjesht më uroi “rrugë të mbarë”. Ndërsa shumica e miqve të mi menduan se isha “çmendur”. Pjesa më e madhe e tyre kanë fëmijë, makina, punë, shtëpi, kanë llogaritë e tyre bankare dhe mendojnë se dhe unë duhet të bëja të njëjtën gjë, pra të marrohem më të dashurën time, të bëja fëmijë dhe një jetë normale si të gjithë të tjerët. Por sot gjerat janë ndryshe. Sot, të gjithë ata më mbështesin, babai, nëna, miqtë e mi dhe mua më duhet se atyre u pëlqen ajo që jam duke bërë.

Po e fejuara si e priti këtë nismë nismë?

Ajo ishte në dijeni që kur lindi kjo ide. Bashkë e projektuaam këtë projekt për gjatë dhjetë muajve. Nisi si diçka e vogël dhe pastaj mori përmasa profesionale deri sa një ditë më në fund u nisa. Ne kemi folur dhe do të vazhdojmë të flasim për sa kohë lidhja jonë do të vazhdojë të jetë e vërtetë dhe ne do të jemi së bashku. Kemi kaluar momente të mira dhe të këqija. Por në tërësi marrëdhënia ka qenë mjaft e mirë dhe vjen duke u forcuar. Para pak kohësh, unë isha në Kenia dhe ajo erdhi të më takonte atje. Unë kisha blerë dhe një unazë dhe i propozova të marrohem. Dhe kështu tani ne jemi të fejuar. Pra mendoj se jemi në rrugë të mbarë.

Jeni nisur në vitin 2013, në orën 10 të datës 10 të muajit të dhjetë, muajit tetor? Mos jini pak supersticioz?

Jo, jo, aspak. Një nga pikat më të rëndësishme në projekte të tilla, është të caktosh datën e nisjes. Dhe së bashku me të dashurën time atëherë, e fejuara ime sot, kërkuam dhe gjetëm se data 10 tetor, ishte një ditë e mirë se përkonin disa dhjeta, dhe në këtë mënyrë do të ishte e lehtë të mbahej mend gjatë.

Cili është vendi parë që vizitove në nismën tënde?

Nga Danimarka shkova në Gjermani,

pastaj në Holandë, Belgjikë, Luksemburg, Francë dhe pastaj vazhdova me 38 vende të Europës, pastaj në të gjithë Atlantikun e Veriut, Amerikën e Veriut, Amerikën Qendrorë, Amerikën e Jugut, Karaibet, të gjithë Afrikën. Tani jam sërish në Europë dhe së shpejti do të shkoj në Lindjen e Mesme.

Me një buxhet vetëm 20\$ në ditë për ushqim, udhëtim, fjetje, a është e vështirë për t’ia dalë ?

Është shumë e vështirë. Por nuk është kaq e vështirë në Shqipëri. Shqipëria është një vend shumë i mirë për projektin tim. E vështirë ishte në Francë dhe akoma më e vështirë në Itali, ku kam qenë pak kohë më parë. Buxheti prej 20\$ në ditë mbulon katër gjëra: fjetjen transportin, ushqimin dhe vizat. Në përgjithësi udhëtoj me transportin publik dhe ushqehem lirë. Jo gjithnjë kam nevojë për një vizë dhe shpesh fle nëpër shtëpitë e vendasve, në konvikte...por nuk është aspak e lehtë.



Cili ka qenë vendi më i çuditshëm deri tani?

Vendi më i çuditshëm ka qenë Vatikani. Vatikani është vend i vogël, një e dhjeta e Parkut Qendror në Nju Jork, nuk ka restorante, hotele, askush nuk ka lindur në Vatikan. Nuk dua të flas për fenë se ajo është tjetër gjë. Por mua më duket e çuditshme që Vatikani të quhet shtet.

Në përgjithësi, njerëzit marrin diçka si kujtim në çdo shtet që vizitoni. Po ti e bën?

Unë marr histori. Takoj njerëz në çdo vend dhe marr historitë e tyre me vete. Në çdo vend që shkoj bëj fotografi sytë e dikujt atje. Kështu që kam sytë e Shqipërisë, Italisë, e kështu me radhë.

vijon në faqen 18

Nga fundi i shkurtit 1919, mbërriti në Shqipëri, Komisioni i Kryqit të Kuq Amerikan (KKA) për Shqipërinë, shefi i parë i të cilit ka qenë Majori Robert C. Dennison, dhe kryeinfermiere për katërbëdhjetë infermiere, pjesë e këtij misioni, ishte Caroline K. Robinson. Ky komision, arriti të ngrinte në gjashtë qytete shqiptare spitale, dispanseri,

infermieret zhvilluan 1349 vizita. Shkodra kishte gjithashtu një jetimore me tridhjetë vajza, që komisioni e ndihmonte me ushqime dhe veshje. Zonja McGovern mbajti atje, mësimet e para për higjienën. Biseda të ngjashme për shëndetin jepeshin prej saj dhe në shkollat e qytetit dhe në kurset e rrobaqepësisë të KKA, të ngritur për të

tyre në dispanserinë * e KKA. Raportet e Znj. Buchanan japin një përshkrim interesant të cilësisë së jetës në këtë qytet:

- Më datë 8 prill 1919, pas tri orësh ngjitje, e gjetëm veten pranë fshatit të vogël të Krujës, qendra e heroit shqiptar Skënder Bej. Rrugët ishin aq të ngushta dhe me gurë, sa nuk e lejonin dot kamionin tonë të hynte në qytet, kështu që ne ecëm në këmbë...

- Shtëpia jonë ishte një shtëpi tipike fshatare shqiptare. Megjithëse e re, ajo ishte ndërtuar me materiale të vjetra. Kur mbërritëm aty, burrat e shtëpisë ishin ulur drejtpërdrejt në dysheme të spërkatur me ujë, në një dhomë të madhe në katin e parë. Për ne të katërt, ishin caktuar dy dhoma të vogla sipër në katin e dytë, një për mjekun dhe përkthyesin, dhe tjetra për infermieret. Unë dhe zonja Kchternach ndamë të njëjtën dhomë dhe e përdorën atë edhe për kuzhinë dhe për dhomë ngrënie.

- Ne gatuanim me qymyr në një pajisje me tri këmbë që quhet mangall. Ndiqnim zakonet shqiptar që mishin ta piqnim jashtë. Një ditë gatuanim byrek: në një vend të sheshtë gatitëm brumin dhe shtruan petat duke përdorur shishen e qumështit. Ishte e mrekullueshme. Byreku u pëlqye shumë.

- Në një dhomë të bollshme në shtëpinë ngjitur, ngritëm dispanserinë tonë, dhe në gjashtë javë në vazhdim u trajtuan një mijë e treqind raste. Në vend ishin të përhapura shumë sëmundje të lëkurës, të stomakut dhe të infeksionit të kockave. Sëmundjet e stomakut i atribuohet ushqimit të varfër, bukës së misrit dhe qumështit të thartuar.

Për fat të keq furnizimi ynë me ilaçe ishte i kufizuar, megjithatë kishim mjaftueshëm kininë, fenacetinë dhe kripëra Epsom. Për kollë përgatisnim shurup, duke përdorur sheqer dhe lëng limoni. Njerëzit në fshat ishin të uritur për ilaçe; austriakët nuk kishin lënë asgjë, ndërkohë që asgjë nuk ishte importuar.

Një infermiere e KKAmerikan duke dhënë mësim higjiene për një grup refugjatësh në Tiranë.



shërbim të infermiereve dhe atë të ndihmës njerëzore, që kanë qenë dhe drejtimet kryesore të ndihmës së KKA në Ballkan.

Në Shkodër, qyteti më verior dhe më i madh në Shqipëri, që kishte një popullsi prej tridhjetë e dy mijë banorësh, komisioni dërgoi një njësi në përbërje të të cilit ishin njëmbëdhjetë punonjës të KKA. Katër prej tyre ishin infermiere, në krye të të cilave ishte Ella McGovern. Qyteti kishte të vetmin spital në Shqipëri, që komisioni e furnizonte me pajisje dhe gjithçka të nevojshme. Në vend që të ndërtonte një institucion të dytë, Komisioni i rriti kapacitete e spitalit deri në njëqind e tridhjetë shtretër. Megjithatë, në qytet kishte nevojë për një dispanseri, dhe për këtë komisioni ngriti një të tillë, nga shërbimet e ofruara prej saj deri më 1 korrik të atij viti, u trajtuan 2606 raste.

Vizitat e infermiereve në Shkodër, që u realizuan në fillim nga Viola Nohr dhe Liesle Wentzel ishin mjaft të suksesshme. Deri më 1 korrik

trajnuar dhe punësuar gratë dhe vajzat, banore të qytetit.

Në Jug të Shkodrës, lumi i Matit që derdhej në Detin Adriatik, me fillimin e shirave të verës kthehej e bëhej shumë i rrëmbyeshëm. Përgjatë pushtimit austriak në vitin 1915, e vetmja urë mbi të u shkatërrua, dhe deri në vitin 1919, dhe nuk ishte rindërtuar akoma. Udhëtimi ishte i mundshëm vetëm me motor, karroca apo në këmbë dhe rrugët ishin shumë të varfra. Kur udhëtarit i duhej të kalonte lumenj si lumin Mat, i duhej t'i lutej atij që kishte trapin apo lundrën për ta hedhur në anën tjetër. Megjithatë, komisioni u përpoq të ngrinte dispanseri në qytetet e vegjël dhe të izoluar shqiptarë, dhe infermieret dhe punonjësit e tjerë, duke treguar një zell të vërtetë, ia dolën mbi vështirësitë që të ofronin rrugët, shpesh piktoreske veçanërisht ato maloret që ishin shumë të bukura. Një qytet i tillë ishte Kruja, ku Marion Echternach dhe Sarah Buchanan realizonin vizitat e infermiereve dhe ku kryenin detyrën e

Shqipëri në vitin 1919

të Kuq në Shqipëri

Disa erdhën dhe na thanë se nuk ishin të sëmurë, por kërkonin ilaçe kur të sëmureshin. Të tjerë na thoni se kishin qenë të sëmurë pesë apo dhjetë vjet më parë, dhe kjo si pretekst për të kërkuar ilaçe tani.

Në një qytet ku kishte pasur një farmaci, mjeku dha një recetë me shkrim për njërin duke i shpjeguar se me atë ai duhej të paraqitej në farmaci, ku do të merrte gjashtë pilula, të cilat duhet t'i përdorte nga një çdo ditë. Ditën e gjashtë, mjeku u habit shumë kur pacienti u paraqitet vetëm me një copëz të vogël të recetës, duke pyetur nëse mund të marrte një tjetër. Pasi e pyeti, për çfarë shikonte, mjeku zbuloi se ai kishte marrë një të gjashtën e letrës çdo ditë. Shumica e barnave tona ishin në formë pluhuri, dhe pacientët së bashku me pluhurin gjëlltisin dhe një copë të letrës së recetës.

Në tërësi, njerëzit e Krujës e vlerësonin dhe e respektonin veten. "Ne nuk kemi lypës," shkruante Mis Buchannan.

Në jug të Krujës ishte Tirana, një kodrinë e vështirë për t'u arritur me njëmijë e dyqind banorë. "Mënyra e vetme për të shkuar në këtë qytet", shkruante Mis Buchannan, është me kalë. Rruga kalonte nëpër terrene kënetore, pjerrtësi dhe shkëmbinj, shpesh me hone nga të dyja anët, ku një hap i gabuar i kalit do të ishte fatal".

Gjashtë infermiere të KKA, përfshirë dhe Mis Robinson, shefe e infermiereve në Shqipëri, u vendosën me detyrë në Tiranë, disa prej të cilëve në një spital të KKA me tridhjetë shtretër. Mis Buchannan për kohën që ishte në mes tyre ka shkruar: "Ne ndihmoheshim nga katër gra cigane

dhe u mësuam mjaft atyre. Gratë e klasave të larta nuk ishte e mundur që të dilnin nga izolimi ku ndodheshin. Shumica e pacientëve tanë ishin burra, pjesa më e madhe kishin plagë me armë zjarri. Këta malësorë luftonin prek kohësh për disa grindje të familjes, të ndodhura kushedi prek kur në kohë."

Në Tiranë, KKA

vendosur në bregun e Adriatikut, ishte kryeqyteti i Shqipërisë, Durrësi. Dy infermieret, Barbara Sandmaier dhe Emily Chancy, shërbyen për disa kohë aty, dhe në maj u transferuan në Tiranë. Në Mars, Sarah Buchannan ndihmoi atje, në Durrës, për të shpërndarë furnizime për gjashtëdhjetë fëmijët që ndiqnin shkollën që ishte e vendosur në një kodër mbi qytet. "I veshëm të gjithë fëmijët e vegjël me

rroba të reja, shkruante Mis Buchannan", por fatkeqësisht ne nuk kishim veshje për më të mëdhenjtë. Fëmijët ndjeheshin mirë në rrobat e reja, por disa prej tyre u ndjenë mjaft në siklet për shkak se jo të gjithë kishin. E këtë modesti të fëmijëve, e kam gjetur kudo në Shqipëri, diçka mjaft e këndshme për t'u parë. "


Në jugperëndim nga Durrësi dhe Tirana, ishte Elbasani i shtirë në një kodrinë. Dhe aty dy infermiere, Annie Slack dhe Margaret Garretson, bënin detyrën e tyre në dispanserinë e ngritur, duke vizituar fshatarët me nevojtarë dhe mirënjohës shqiptarë.

Nga Elbasani, Miss Buchannan shkoi me një dispanser të lëvizshme në Kavajë, dhe për katër ditë që ishte aty me detyrë, trajtoi treqind pacientë.

"Se çfarë ndjenim," shkruante Mis Buchannan, "shpesh dilte nga kurniza e kuriozitetit. Ne pamë të njëjtën situatë të zakonshme si dhe në qytetet e tjera për tuberkulozin dhe sifilizin."

Korça ishte qyteti më në Jug të Shqipërisë, ku komisioni ngriti një dispanser spital dhe një shërbim infermierie për të bërë vizitat. Në mesin e tetë mijë banorëve të Korçës, kishte shumë të krishterë dhe shumë amerikanë dhe shqiptarë që kishin qenë në Shtetet e Bashkuara. Prandaj, dhe puna e KKA pati sukses.

Përgatiti Z. Muça



kishte një shërbim aktiv dispanserie. Dy nga infermieret punonin rreth e qark qytetit. Një zhvillim interesant i dispanserisë në Tiranë ishte një njësi e lëvizshme e cila vepronte në kodrinat në afërsi të qytetit. Në Shëngjergj, kjo njësi trajtoi në katër ditë, 374 pacientë. Lucy Joaquim, ishte një infermiere e shëndetit publik që shoqëroi dispanserinë e lëvizshme në udhëtimin e saj. Ndërkohë që njësi në Tiranë, furnizonte me ilaçe dhe shërbim infermierie një jetimore që ndodhej në qytet.

Në perëndim të Tiranës, dhe e

Ndihma që Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe e Gjysmëhënës së Kuqe (Lëvizja) për emigrimin është tërësisht humanitare dhe bazohet në njohjen e nevojave dhe të dëshirave të emigrantëve. Ajo fokusohet në plotësimin e nevojave më emergjente, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Nisur pikërisht nga shkalla e gjerë e shqetësimeve njerëzore të emigrimit, përkufizimi i Kryqit të Kuq (KK) për emigrantin është qëllimisht i gjerë.

“Emigrantët janë persona që largohen ose ikin nga vendbanimi i tyre i zakonshëm për të shkuar në vende të reja - zakonisht jashtë vendit - për të kërkuar mundësi ose perspektiva më të sigurta dhe më të mira. Emigrimi mund të jetë vullnetar ose i pavullnetshëm, por në shumicën e kohës mbetet një kombinim i zgjedhjeve, por dhe i kufizimeve të individëve”.

Pikërisht për këtë përdorimi i termit “emigrant” përfshin: emigrantët e punës; emigrantët për arsye shtetërore; emigrantët që konsiderohen të parregullta nga autoritetet publike; emigrantët e zhvendosur brenda vendit të tyre; refugjatët dhe azilkërkuesit. Veprimtaritë konkrete për dhe me emigrantët e pambrojtur, është një nga veprimtaritë më të hershme të Lëvizjes në të gjithë botën.

KK dhe GjK ka mandat për të ofruar mbrojtje dhe ndihmë humanitare për emigrantët në nevojë, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Politika për Migracionin, e miratuar nga Këshilli i Delegatëve të Lëvizjes, në nëntor të vitit 2009, qartëson rolin e KK dhe GjK në adresimin e shqetësimeve humanitare të emigrantëve, ndërsa Rezoluta 3 e Konferencës së 31-të Ndërkombëtare të KK dhe të GjK i kërkon Shteteve që t’u krijojnë ligjërisht siguri Shoqatave Kombëtare për të pasur një qasje efektive dhe të sigurt për të gjithë emigrantët. Vitet e fundit, ka pasur një rritje dramatike të numrit të viktimave midis emigrantëve që lëvizin nga Afrika dhe Lindja e Mesme, ndërsa përpiqen të kalojnë Detin Mesdhe

Shoqatat e KK dhe të GjK ofrojnë një shumëllojshmëri programesh dhe

shërbimesh për të ndihmuar dhe mbrojtur emigrantët sipas nevojave të tyre. Bazuar në një hartë të gjerë të 25 vendeve përgjatë rrugëve kryesore emigratore, plani i përgjigjeve identifikon tri linja kryesore: Asistencë humanitare në qendrat e pritjes në kufi: ushqim, strehim, veshmbathje, kujdes shëndetësor, ndihmë të parë, ndihmë psiko-sociale dhe rivendosje të lidhjeve familjare; Mbrojtje: mbrojtje të jetës dhe sigurim të respektit për individët me synim që autoritetet vendore dhe aktorë të tjerë të respektojnë detyrimet e tyre dhe të drejtat individuale; Ndërgjegjësim të publikut dhe promovim të respektit për diversitetin, jodhunën dhe përfshirjen sociale.

Analiza e situatës dhe reagimi në vazhdimësi

Vlerësohet se vetëm gjatë vitit 2015 kanë mbërritur në Europë 1,011,700 emigrantë nga deti në 2015, dhe rreth 34,900 nga toka. Sipas FRONTEx, që monitoron kufirin e BE, numri i të ardhurve që kanë kaluar në BE në vitin 2015 është më shumë se 1,800,000, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë vetëm 280,000 të ardhur. Deri në fund të muajit maj 2016, UNHCR raporton rreth 200,000 emigrantë të ardhur nga deti. Deti Mesdhe mbetet një nga rrugët më të rrezikshme në botë. Vetëm në vitet 2015-2016 kanë humbur jetën 8,562 persona.

Kjo lëvizje e njerëzve përbën një nga më të mëdhatë në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. Shumica e emigrantëve që vijnë me det nga Turqia janë larguar nga vende të shkatërruara nga lufta si Siria, Afganistani, Iraku.

Përballë kësaj situatë, shumë vende përgjatë rrugës emigratore nga Ballkani Perëndimor përnë Europën Perëndimore u kanë bërë thirrje shoqatave kombëtare të KK dhe aktorëve të tjerë humanitarë që të ofrojnë ndihmë në pikat kufitare të kalimit dhe në qendrat e pritjes të ngritur enkas për këtë. Shoqatat Kombëtare në Evropën Veriore dhe atë Jugore reagues në shkallë të gjerë për të ndihmuar më nevojtarët. Federata ndërkombëtare lëshoi një apel ndihme në shumën e

20 milion frangave zvicerane për të mbështetur veprimtarinë e Shoqatave të KK të Kroacisë, Greqisë, Hungarisë, Italisë, Maqedonisë dhe Serbisë. Shoqatat e panë rolin kryesor të tyre, në lehtësimin e lëvizjes së emigrantëve përmes territorit të vendeve të tyre. Në vitin 2016, një rrugë tjetër e madhe emigrimi, ajo nga Libia në Itali, njohu rritje.

Në mars të viti 2016 u nënshkrua marrëveshja ndërmjet BE dhe Turqisë për të kthyer në Turqi të gjithë emigrantët e rinj, që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe të gjithë emigrantët e parregullt. Kjo marrëveshje synon të zvogëlojë rrjedhën e emigrantëve që hyjnë në BE nga Turqia. Meqenëse numri i emigrantëve që vijnë në shumë vende evropiane është zvogëluar, shumica e Shoqatave Kombëtare kanë kaluar nga mënyra e reagimit në emergjencë në asistencë afatgjatë në qendrat e pritjes dhe në komunitet.

Sfidat kryesore për Kryqin e Kuq dhe Gjysmëhënën e Kuqe

Shumë shoqata kombëtare në BE kanë shprehur shqetësimin për akomodim dhe shërbime të pamjaftueshme në vend për të mirë-pritur një numër në rritje të emigrantëve të rinj. KK dhe GjK, në mbështetje të autoriteteve publike, synon të sigurojë:

- për të gjithë emigrantët mundësinë e një strehimi të përkohshëm;
- zgjidhje dhe procedura më të qëndrueshme për azilkërkuesit.

Për realizimin e këtyre objektivave, KK dhe GjK u duhet të përballen me disa sfida dhe të marrin masa për t’u përballur me to:

- Shumë emigrantë që vijnë në Evropë janë detyruar të largohen nga shtëpia për shkak të konfliktit, dhunës, persekutimit dhe represionit. Emigrantët mund të jenë veçanërisht të prekshëm për arsye të mungesës së statusit ligjor, ndarjes së familjes, vështirësive ekonomike, dhunës, dhe kombësi. Situata e të miturve të pashoqëruar është veçanërisht shqetësuese.

- Rekrutimi dhe trajnimi i vullnetarëve është një tjetër sfidë për shoqatat kombëtare si një nga kriteret tejet i rëndësishëm për të siguruar vazhdimësinë dhe efektivitetin e përgjigjeve të KK dhe GjK;
- Sigurimi i ndihmës për të gjithë emigrantët në të gjitha vendet është një tjetër sfidë. Shumë emigrantë që mbërrijnë në Evropën Jugore qëndrojnë në këto vende më shumë se 12 deri në 48 orë. Kjo ka bërë që shoqatat kombëtare të zhvendosin shërbimet e tyre humanitare në pikat e kalimit kufitar dhe në qendrat e kalimit dhe ndalimit, zona ku më herët nuk kishin prezencë. Për më tepër që rrugët emigratore kanë ndryshuar, çka ka bërë që shoqatat të përshtaten duke ofruar shërbime të tilla si ndihmë sociale dhe përkujdes shëndetësor.
- Trajtimi i racizmit dhe ksenofobisë - Promovimi i tolerancës dhe respektit shoqëror është në thelbin e veprimit të KK dhe të GjK me qëllim luftimin e çdo sjelle apo qëndrimi diskriminues dhe ksenofob ndaj emigrantëve. Lëvizja nuk bën dallime në bazë të kombësisë, racës, besimit fetar, klasës apo mendimit politik.
- Të folurit me një zë të përbashkët: avokatimi për politikën e BE-së dhe emigracionit kombëtar. Ndërsa migracioni është një çështje shumë e politizuar në Evropë, aftësia për të ndikuar në vendimmarrësit varet nga zhvillimi i mesazheve të qarta të përbashkëta dhe rekomandimeve të politikave, të cilat sigurojnë se përgjigjet operacionale dhe ato politike janë adekuate për të adresuar situatën.
- Ndikimi në zgjidhjet e BE-së dhe të politikës së kufirit, veçanërisht mungesa e rrugëve të sigurta ligjore për emigracionin, mund të krijojë më shumë vështirësi dhe dobësi shtesë për azilkërkuesit. Kërkohet përpjekje për të avokuar për politika më të mira dhe më të qëndrueshme të BE-së në fushën e migrimit dhe azilit që marrin parasysh nevojat humanitare të të gjithë emigrantëve.

Kriza e emigrimit dhe Kryqi i Kuq Shqiptar

Shoqata ka ndjekur me vëmendjet zhvillimet e kësaj krize në Europë dhe më konkretisht në vendet fqinje, të cilat kanë qenë e itinerarit të rrugës së transit të Emigrantëve drejt vendeve perëndimore. Ajo është fokusuar kryesisht në dy drejtime:

- Në përgatitjen e kapaciteteve njerëzore të shoqatës, veçanërisht të skuadrave të ndërhyrjes në raste katastrofash; dhe
- Organizimin e ndihmës konkrete materiale në rast fluksi të refugjatëve.

Janë pikërisht 13 degët që ndodhen përgjatë kufirit me Greqinë dhe Maqedoninë, të përfshira në këtë projekt. Ato mobilizuan skuadrat e ndërhyrjes në raste katastrofash, në një numër prej 30-40 vullnetarësh për degë, gjithsej 600 vullnetarë, të cilët morën instruksionet e nevojshme për të ndërhyrë në rast nevoje. Për këtë u organizuan dy seminare me vullnetarët dhe punonjës e degëve të mësipërme me qëllim rifreskimin e njohurive dhe të trajnimit për temat të tilla si : ndihma e parë, ndihma psiko-sociale, rivendosja e lidhjeve familjare; dhe informacioni.

Gjatë vitit 2016, janë raportuar 915 emigrantë në kufij dhe brenda territorit të vendit. Vetëm 240 individë nga 915 emigrantë kanë kërkuar azil shumicën e tyre sirianë, iranianë dhe afganë. Të gjitha rastet e raportuara janë ndihmuar me paketa ushqimore, kuti higjienike dhe veshje nga UNHCR, Karitas, Qendra Kombëtare për Refugjatët dhe KKSH. Ndërkohë me kërkesë dhe në koordinim me Drejtorinë e Azilit në Shqipëri, KKSH ka bërë dy shpërndarje për 260 emigrantë të vendosur në qendrën kombëtare për refugjatët në Tiranë me ushqime, batanije dhe kite higjienike, pjesë e stokut të emergjencës së shoqatës. KKSH është në kontakt të përhershëm me strukturat e Federatës ndërkombëtare të KK dhe të GjK në ndjekje të situatës me qëllim marrjen e masave në kohë në ndihmë të më nevojtarëve.

Përgatiti Z. Muça





30 Maj – Projekti DDA “Të rinjtë kundër përdorimit të Drogave, Duhanit, Alkoolit”. Në vitin 2017, gjeografia e projektit u shtri në 17 degë nga 12 një vit më parë. Projekti ka në fokus rininë shkollore, nxënësit e vitit të fundit të shkollave nëntë vjeçare, nxënësit e shkollave të mesme dhe të rinjtë e ndërmarrjeve prodhuese.

Çdo muaj, vullnetarët e Kryqit të Kuq realizojnë 35-40 takime, me pjesëmarrjen e rreth 1200 të rinj, shifër kjo që në një vit shkon në 12-13 mijë të rinj përfitues. Projekti mbështet nga donatori : “Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të më Vonshme”. Projekti është mirëpritur nga të rinjtë vullnetarë, të cilët gjejnë në veprimtaritë që organizohen, mundësinë për të diskutuar për problemet që i shqetësojnë.



1 Qershori, një ditë për fëmijët në Degën e KK, Tiranë. Falë kontributit të të gjithë komunitetit dhe në veçanti të nxënësve të shkollave të qytetit, u ndihmuan 40 fëmijë në komunitet, të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli”. dhe të fëmijëve të grave në nevojë të Kurseve të Rrobaqepësisë dhe të Kuzhinës pranë degës së KK Tiranë. Dhuratat për fëmijët u mundësuan nga ABI Bank, Forcat e Armatosura, Aeroporti “Nënë Tereza”, nxënësit e Shkollës jopublike “Kristaq Rama”, “Arsakeio”, “Vasil Shanto”, etj.



14 Qershor – Dita e Dhuruesve Vullnetar të Gjakut është dita ku kulmon fushata e sensibilizimit të dhurimit vullnetar të gjakut e KKSH. Në të gjithë vendin, vullnetarët e KK sensibilizojnë publikun e gjerë, dhe kolektiva të ndryshme të institucioneve shtetërore apo private për të dhuruar gjak për fëmijët talasemikë. Vetëm më 14 qershor, falë këtij sensibilizimi janë dhuruar 200 njësi gjak. Një fushatë e tillë nuk do të mundej të realizohej pa kontributin e vyer të të gjithë vullnetarëve të KK, e veçanërisht vullnetarët e Klub 25!



20 Qershor – Një platformë e re dixhitale në Ditën Botërore të refugjatëve do të sjellë informacionin e domosdoshëm dhe të përshtatshëm për refugjatët dhe emigrantët në nevojë. “Vullnetari Virtual” – është një aplikacion miqësor nëpërmjet telefonit celular, i realizuar nga FNKK& GjK dhe IBM - ndihmon njerëzit që emigrojnë për të pasur një qasje prak-tike në informacione dhe mbështetje të besueshme kudo që ata ndodhen. Vullnetari Virtual është shtrirë tashmë në Greqi dhe në Suedi ku është përdorur nga rreth 30,000 persona.

22 Qershor - Programi i Rinisë zhvilloi trajnimin për lider rinie dhe vlera humanitare me 24 të rinj vullnetarë,

të 12 degëve të Kryqit të Kuq Shqiptar. Në këtë trajnim të rinjtë vullnetarë të KKSH rrisin kapacitetet e tyre në drejtim të leadershipit, me qëllim që nesër të jenë ata nxitës dhe promovues të KK te bashkëmoshatarët e tyre. Leadershipi dhe cilësitë e tij, vetëbesimi, vlerat humanitare të KK, etj. ishin disa nga temat e zhvilluara me të rinjtë. KKSH i kushton një rëndësi të madhe të rinjve të shoqatës, sepse ata përbëjnë pjesë më të madhe të anëtarëve dhe vullnetarëve.



5 korrik - Falë një bashkëpunimi një vjeçar me Institutin Kanadez të Teknologjisë dhe punës intensive të pedagogëve dhe studentëve të këtij instituti, Kryqi i Kuq Shqiptar ka realizuar një database të rëndësishme online për regjistrimin e anëtarëve dhe vullnetarëve të shoqatës. Ishte kjo arsyeja e organizimit në EU Information Center, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, të një ceremonie, ku Rektori i Institutit Kanadez të Teknologjisë, Prof. Dr. P. Eng. Habib Hamam, i dhuroi Presidentit të KKSH z. Ylli Alushi “Database i të dhënave për anëtarët dhe vullnetarët e KKSH”.

Realizimi i këtij sistemi është një shem-bull i mirë i bashkëpunimit tërësisht vullnetar ndërmjet një institucioni të lartë arsimor, siç është Instituti Kana-dez i Teknologjisë, dhe një organizate humanitare vullnetare siç është KKSH.



Shqiptar dhe të Lëvizjes ndërkombëtare Gjysmëhënës së Kuqe

12 Korrik - Programi Shërbimi i Trajnimit për Ndhimën e Parë organizoi testimin në nivel kombëtar të të gjithë instruktorëve të Ndhimës së Parë, përfaqësues të të gjithë degëve të KK.

I konceptuar në katër seanca, të shtrira në dhjetëditëshin e parë të muajit korrik, ky testim synoi të provonte në praktikë njohuritë e Ndhimës së Parë nga të gjithë instruktorët e këtij programi, si hallka kryesore që përcjell njohuritë dhe praktikën më të mira të vullnetarët e Kryqit të Kuq, të publiku i gjerë dhe të grupet shenjë. Testimi tregon rëndësinë që shoqata i jep në rradhë të parë krijimit të kapaciteteve njerëzore sa më cilësore në fushën e shërbimeve të Ndhimës së Parë, me qëllim zgjerimin e tyre. Kujtojmë këtu marrëdhëniet e krijuara me Federatën Shqiptare të Futbollit, ku ekipet e NP të Kryqit të Kuq janë prezentë në ndeshjet kombëtare dhe ndërkombëtare të futbollit apo dhe veprimtaritë masive publike të zhvilluara nga autoritetet vendore, veçanërisht në Tiranë.



24 korrik - Nga veprimtaritë e degës së KK Vlorë. Në stinë të nxehtë të verës, veprimtaritë e degës janë orientuar drejt pushuesve dhe komunitetit. E tillë është Ndhimja e Parë në bregdet, veprimtaritë e projekteve të shëndetit, e veçanërisht ato që kanë të bëjnë me luftën kundër HIV/AIDS, apo substancave që krijojnë varësi Drogës, Duhanit, Alkoolit. Dega ka treguar kujdes të shtuar për realizimin sa më cilësor të projektit "Një vakt i ngrohtë për të moshuar të vetmuar",

ku ndihmohen 60 moshuar në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, por dhe për zhvillimin e Kurseve të Ndhimës së parë për kandidatët për drejtues automjeti.



1 Gusht - Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Dibër - Përfunduan kampet verore përfitues të të cilëve ishin 200 fëmijë të moshave 6-13 vjeç. Për katër javë, të rinjtë vullnetar dhe personeli përgjegjës për kampet zhvilluan një program të ngjeshur me veprimtari pa fund për fëmijët, argëtues dhe informuese si: të drejtat e fëmijëve, bulizmi, higjiena personale dhe ajo komunitare, njohuri të thjeshta mbi ndihmën e parë, lojra kreative, etj. Këto kampe u organizuan falë mbështetjes së World Vision.



9 Gusht - Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe është e tronditur dhe thellësisht e pikëlluar nga vdekja e dhunshme e gjashtë vullnetarëve të KK, në Republikën e Afrikës Qendrore. Vullnetarët e KK po merrnin pjesë në një takim në një institucion shëndetësor në Gambo në Jug Lindje të Republikës së Afrikës Qendrore më 3 gusht. Lëvizja e Kryqit të Kuq dënon me forcë këtë incident, i

treti që nga fillimi i vitit në Republikën e Afrikës Qendrore, dhe kërkon me forcë mbrojtjen e jetës së personelit të Kryqit të Kuq.



22 Gusht - Vullnetarët e Degës së Kryqit të Kuq Durrës, janë fokusuar në organizimin e seancave të informimit kryesisht në fushën e shëndetit, me moton "Është më mirë të parandalosh". Veprimtaritë e organizuara kanë të bëjnë me luftën kundër HIV/AIDS, apo substancave që krijojnë varësi si Droga, Duhanit Alkooli. Dhe për arsye të stinës së verës vullnetarët e projektit i janë drejtuar sipërmarrjeve private, dhe më konkretisht fasonerive, ku dhe numri i punonjësve të moshës së re është gjithnjë e më i madh.



31 Gusht - Drejtor i Zyrës për Europën i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, Dr. Simon Misiri, vizitoi Kryqin e Kuq Shqiptar dhe degët e tij në Shkodër, Tiranë dhe Elbasan, si pjesë e një ture ballkanike. Gjatë kësaj vizite ai u shoqërua nga Presidenti i KKSH, Magj. Ylli Alushi dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Artur Katuçi të cilët e njohën më nga afër me punën e bërë nga Kryqi i Kuq Shqiptar, dhe nga degët e tij, në ndihmë të më nevojtarëve, veçanërisht në fushën e përgatitjes dhe ndërhyrjes në raste katastrofash, atë sociale, të shëndetit apo të ndihmës së parë.

vijon nga faqe 11

Dhe në fund të projektit, do të bëj një kolazh me fotografitë e syve të njerëzve. Kam bërë fotografi të perëndimit të diellit në çdo vend dhe zakonisht marr një dhuratë të vogël, por që e dhuroj në vendin pasardhës që vizitoj. Kështu që në vendin tim në Danimarkë do të çoj dhuratën nga vendi i fundit që do të vizitoj për të mbyllur ciklin.

Ka pasur ndonjë situatë të vështirë gjatë udhëtimit tuaj?

Shumë, shumë situata të vështira. Ka pasur shumë arsye të forta për t'u kthyer në shtëpi, për ta lënë projektin në mes, por nuk e kam bërë këtë. Kam kaluar malarien dhe më ka bërë shumë keq. Për një kohë të gjatë jam ndjerë shumë i dobët. Kam vuajtur korrupsionin, por dhe situata të vështira financiare. Kam humbur sponsorin, më ka vdekur gjyshja dhe nuk shkova dot në funeral për shkak të rregullave të projektit. Më merr malli për shtëpinë, për të fejuarën, për miqtë.

Të është rrezikuar ndonjëherë jeta?

E vështirë ta them, por besoj se po. Jeta ime është rrezikuar disa herë, por ia kam dalë dhe ja ku jam prapë. Mendoj se një nga pjesët më të rrezikshme është trafiku. Edhe këtu në Shqipëri, ndonjëherë është e rrezikshme kur kalon rrugën. Njëherë isha në një anije të vogël që mund të mbytej lehtësisht, që nuk kishte asnjë mjet shpëtimi, as dhe një jelek dhe kjo ishte mjaft e rrezikshme. Një herë tjetër në xhungël kam hasur disa të dehur të armatosur që nuk më pëlqyen aspak. Dhe në këtë rast mund të kishte shkuar keq. Me malarien mund të kishte shkuar keq, po të mos kisha shkuar në spital.

Duke shpresuar se ti do t'i vizitosh të 205 vende që i ke vënë synim vetes, çfarë do të bësh me gjithë këtë eksperiencë që ke mbledhur, gjithë këto kultura në gjithë këto vende që ke vizituar?

Gjëja e parë që do të bëj sapo të kthehem në vendin tim, është që do të fle për një muaj të tërë. Dhe pastaj do të zgjohem e do të rruhem. E pastaj, nëse nuk do të jem martuar deri atëherë,

do të martohem. Pastaj do të nis të shkruaj një libër, me qëllim që të njoh njerëzit me kultura të ndryshme në mbarë botën, për t'u treguar njerëzve se bota nuk është e frikshme, se njerëzit janë kudo pothuajse njësoj, familjet janë kudo të lidhura ngushtë, të gjithë kanë Facebook, të gjithë bëjnë "selfie" Të gjithë bien në dashuri, u pëlqen të kërcejnë, u pëlqejnë sportet, të gjithë duan motin e mirë dhe ankohen për motin e keq. Njerëzit janë njerëz kudo në botë.

Ju jini ambasador i dëshirës së mirë i Kryqit të Kuq. Cili është misioni juaj në këtë rrugëtim?

Unë jam ambasador i dëshirës së mirë për Kryqin e Kuq Danez. Kryqi i Kuq Danez është një nga mbi 190 shoqatat kombëtare të Kryqit të Kuq në botë, sepse Kryqi i kuq gjendet kudo në botë. Pak a shumë Kryqi i Kuq ndodhet në çdo shtet. Unë vizitoj Kryqin e Kuq vendas në të gjitha vendet ku shkoj. Shkova dhe në Kryqin e Kuq Shqiptar dhe mësova se sa i fortë është, sesa të fortë janë vullnetarët, në dhënien e Ndihmës së Parë dhe sesi po kontribuon Kryqi i Kuq në Shqipëri në sigurinë e njerëzve në problemet e vendit.

Të është ofruar ndonjë kompani filmi për ta bërë jetën tënde një film?

Po më kanë kontaktuar producentë të ndryshme dhe jo shumë larg në kohë më ka kontaktuar dikush që donte të bënte një dokumentar të vizitës time në Libi, por dhe një kompani filmi është shprehur se do të bëjë një film mbi projektin tim, ashtu sic jam kontaktuar dhe nga Shtëpi botuese të librit, të cilët më kanë ofruar të shkruaj një libër. Më kontaktojnë, por në të shumtën e herës ata zhduken dhe përsëri shfaqen sërish. Në fund të projektit do të shohim se çfarë do të ndodhë

- **Faleminderit!**

Intervista është realizuar nga gazetari Ani Elezi për Vision TV

vijon nga faqe 10

të cilat janë transmetuar tek individët dhe komuniteti; organizimi i takimeve të drejtpërdrejta, shtypshkrimet e përditësuara, përdorimi i rrjeteve sociale, spotet TV, emisionet në radio e TV, por dhe lobimet, të konsideruara si mjete mjaft efikase, për të arritur objektivat e programit.

Në 14 Qershorin e 2017, me rastin e Ditës Botërore të Dhuruesve Vullnetarë, më shumë se 30 degë organizuan veprimtari promociionale, ndërkohë që në dy javët e para të muajit qershor u realizua dhurim në 20 degë të KKSH. Përmendim, emisionet TV në Tiranë dhe në disa rrethe, takimet e dendura në institucione, lobime në autoritetet lokale, vendosjen e CT-light në Tiranë, dhe të roll-up-et në 12 degët e mëdha e në 5 të mesme dhe shtypshkrimet e shpërndara në të gjithë vendin, prej vullnetarëve tanë. Përmendim këtu ngritjen e çadrës për dhurim gjaku në Tiranë, ku njerëz të ndryshëm, kalimtarë, kthenin dhe dhuronin gjak.

Në muajin Qershor, vetëm si kontribut i KKSH, u arrit që të dhuroheshin 681 njësi dhe nga muaji Janar 3820 njësi gjaku. Përmendim këtu degët e KK Gramsh, Elbasan, Tiranë, Durrës, Lezhë, Berat, Shkodër, që janë në pararojë të arritjen e rezultateve, e po kështu Degët e KK Malësi e Madhe, Pukë, Vlorë, Fier, Korçë për rezultate të mira e përpjekje të lavdërueshme.

Dhe kështu se nga viti në vit numri i individëve, i institucioneve vendase e grupeve të ndryshme, i përfaqësive të huaja në vendin tonë, ku vend të veçantë zë ajo amerikane me angazhimin cdo vit në që ofrohen për dhurim vullnetar, vjen në rritje, duke shtuar shpresat se një ditë jo të largët edhe vendi ynë do t'i plotësojë nevojat për gjak, duke u rreshtuar kështu në krah të vendeve të zhvilluara e me shoqëri të emancipuar në Europë.

*Armand Pambuku
Koordinatori i Programit Shëndetësor
dhe Dhurimit Vullnetar të Gjakut*

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq

dhe e Gjysmëhënës së Kuqe në të cilën bën pjesë edhe Kryqi i Kuq Shqiptar, përfshin tre përbërës: Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (Federata Ndërkombëtare) dhe Shoqatat Kombëtare.



Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) si organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, ka misionin e posaçëm humanitar për të mbrojtur jetën dhe dinjitetin e viktimave të luftës dhe të dhunës së brendshme si dhe për t'u dhënë atyre ndihmë. Ai drejton dhe koordinon aktivitetet ndërkombëtare të ndihmës së gjithë Lëvizjes, në situatat e konflikteve. Përpiqet gjithashtu që të parandalojë vuajtjen njerëzore nëpërmjet promovimit dhe forcimit të së drejtës dhe parimeve humanitare universale. I krijuar më 1863, KNKK-ja është në origjinë të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe. Ai e ka njohur Kryqin e Kuq Shqiptar, në vitin 1923.

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, anëtar i së cilës është dhe Kryqi i Kuq Shqiptar që nga viti 1923, i përkushtohet sipas Parimeve themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, frymëzimit, favorizimit dhe promovimit të aktiviteteve humanitare të zhvilluara prej Shoqatave Kombëtare me qëllim përmirësimin e gjendjes së njerëzve më në nevojë. E themeluar më 1919, Federata Ndërkombëtare drejton dhe koordinon ndihmën ndërkombëtare të Lëvizjes për viktimat e katastrofave natyrore apo teknologjike, për refugjatët dhe për rastet e situatave të jashtëzakonshme shëndetsore. Ajo inkurajon bashkëpunimin mes Shoqatave Kombëtare dhe përpiqet që të formojë kapacitetin e tyre për realizimin e programeve efikase në fushat e përgatitjes për ndërhyrje në raste katastrofash, shëndetit dhe ndihmës sociale.

Shoqatat Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (një prej të cilave është dhe Kryqi i Kuq Shqiptar) vënë në jetë qëllimet dhe parimet e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në 186 vende të botës. Ato përmbushin atje rolin e ndihmësve të pushtetit publik për gjithçka që lidhet me çështjet humanitare dhe kryejnë veprimtari në fusha të tilla si: ndihma në rastet e katastrofave, shërbimet në sektorin e shëndetit dhe ndihma sociale. Në raste lufte ato i japin ndihma popullsisë civile të prekur prej saj dhe u ofrojnë mbështetje shërbimeve shëndetsore të ushtrisë.

Të gjithë përbërësit e **Lëvizjes Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe** udhëhiqen nga shtatë parimet themelore:


humanizmi, paanësia, asnjëanësia, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe universaliteti

Po ashtu dhe të gjitha aktivitetet e Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe synojnë të njëjtin objektiv: **të ndihmojnë ata që vuajnë, pa asnjë lloj diskriminimi, duke kontribuar kështu për paqen në botë**



**Mos prit derisa katastrofa të godasë
Çfarë mund të bësh ti?**

**DHURO GJAK
DHURO TANI
DHURO SHPESH**



Dita b  tërërore e dhuruesve të gjakut

Dhuro gjak. Dhuro tani. Dhuro shpesh. 14 QERSHOR 2017



**World Health
Organization**